

28 shkurt 2020

Të dashura familje Agawam,

Ne e kuptojmë që shumë familje kanë pyetje në lidhje me përhapjen e vonët të llojit të ri Koronavirus dhe se si mund të ndikojë ky në komunitetin tonë lokal. Qendra Për Kontrollin dhe Parandalimin e Sëmundjeve (CDC-ja) po ofron freskime dhe rekomandime të përditshme. Lutemi klikoni në linkun e mëposhtëm, për të qëndruar në korent të ngjarjes: <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-ncov/index.html>.

Edhe pse ky është një shqetësim shëndetësor publik, CDC-ja vazhdon të raportojë që rreziku i menjëhershëm ndaj publikut të përgjithshëm mbetet i vogël në këtë kohë. E megjithatë, në botën e sotshme kaq të lidhur, me një numër të madh të familjeve të distriktit që udhëtojnë gjatë javëve të pushimit shkollor, mundësia për sëmundjet infektuese është gjithmonë shqetësuese. Ashtu si edhe me gripin sezonal dhe me infeksionet e streptokokut, këto janë masat paraprake të përgjithshme që mund t'i marrim të gjithë, për të qëndruar sa më të shëndetshëm që të jetë e mundur.

- Praktikoni higjenë të mirë të duarve. Lani duart shpesh dhe mirë me ujë dhe sapun për të paktën 20 sekonda. Shmangni preken e syve, hundës dhe gojës me duar të palara. Përdorni sanitues me bazë alkoholi kur nuk keni në dispozicion ujë dhe sapun.
- Kur kolliteni dhe/ose teshtini, mbuloni gojën dhe hundën me shami letre. Gjithashtu mund të kolliteni ose teshtini në mëngën tuaj. Hidhini shamitë e përdorura të letrës në plehra dhe menjëherë lani duat me ujë dhe sapun për të paktën 20 sekonda.
- Shmangni përdorimin e gotave, filxhanëve, lugëve, pirunjve, thikave, pjatave, peshqirëve apo sendeve të tjera që janë përdorur nga të tjerët. Lajini këto sende mirë me ujë dhe sapun pas përdorimit të tyre.
- Shmangni kontaktin e afërt me njëri-tjetër që janë të sëmurë, sa herë që të jetë e mundur.
- Praktikoni zakone të mira të tjera të shëndetshme: Pastroni dhe dizinfektoni sipërfaqet që preken shpesh në shtëpi, në punë ose në shkollë, sidomos kur dikush është i sëmurë. Flini mjaftueshëm, qëndroni aktiv fizikisht, menaxhoni stresin, pini lëngje të mjaftueshme dhe hani ushqime të shëndetshme.

Është e rëndësishme që t'i mbani fëmijët në shtëpi dhe mos t'i çoni në shkollë nëse janë të sëmurë. Nëse fëmija juaj ka ndonjë nga simptomat e mëposhtme, lutemi mbajini ata në shtëpi dhe mos i dërgoni në shkollë: temperaturë më të lartë se 100.4; kollë; të vjella; diarre; çdo lloj skuqje që nuk është diagnostikuar nga mjeku; sy me ngjyrë rozë ose të kuqe, që kruhen; dhe/ose rrjedhje lëngjesh nga sytë; dhe gjithashtu për çdo lloj sëmundje ngjitëse si lija e dhenve, streptokok në fyt, ose grip. Ashtu siç e dini, rregullorja e frekuentimit shkollor të distriktit tonë nxit që të merrni letër nga mjeku kur fëmija është i sëmurë, në mënyrë që të justifikohet mungesa e fëmijës. Megjithatë, gjatë kohës që koronavirusi është një shqetësim tepër i madh, ne do ta zbusim atë rregullore dhe nuk do të kërkojmë letër nga mjeku.

Koronavirusi i llojit të ri është një situatë në zhvillim e sipër dhe ne po e ndjekim nga afër, dhe ne do të vazhdojmë t'ju dërgojmë ju informacion të rifreskuar. Lutemi jini të sigurt që ne po i vëzhgojmë shqetësimet shëndetësore të studentëve. Ne jemi në komunikim të afërt me Përfaqësuesin tonë lokal Shëndetësor, me Departamentin e Shëndetit Publik/Njësinë e Shëndetit Shkollor të Maseçusets, si dhe ofruesit e kujdesit shëndetësor pediatrik në zonën tonë. Departamenti i Mirëmbajtjes së Ndërtesës po bën sanitimin vigjilent të hapësirave tona mësimore, ashtu siç e bëjmë këtë zakonisht gjatë sezonit të sëmundjeve të të ftohur; s dhe gripit. Qëndroni të sigurt që ne po i ndjekim të gjitha udhëzimet e rekomanduara për të siguruar sigurinë e studentëve dhe personelit tonë.

Ne qëndrojmë shumë të zotuar ndaj mirëqenies së studentëve dhe personelit tonë dhe do të vazhdojmë që të ndajmë informacion të ri me ju rreth kësaj situatë në zhvillim, ashtu siç del e nevojshme dhe kur vihet në dispozicion.

Sinqerisht,

Steven P. Lemanski
Shef i Arsimit

af

c: Komisioni i shkollave